



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2020:179864

Datë: 21.02.2023

Numri i dokumentit: 03994703

PPP.nr.19/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike përmbareme të kreditorit të përbarimit I. Z., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S. K. avokat në Prishtinë, kundër debitorit të përbarimit Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit numër P.nr.2613/20 i datës 16.10.2020, të lejuar nga Përmbaresi Privat A. M., i caktuar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 09.02.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET prapësimi i debitorit Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës në Prishtinë, SHFUQIZOHET Urdhri përbarimor P.nr.2613/20 i datës 16.10.2020, lejuar nga përmbaresi privat A. M., për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

**A r s y e t i m**

Organi Përmbaresi-Përmbaresi Privat A. M., i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit të përbarimit, me urdhërin P.nr.2613/20 të dt:16.10.2020 e ka caktuar përbarimin në këtë çështje përmbareme në bazë të dokumentit përmbare-

Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.01-14-265/2020 të dt:17.04.2020, pas vlerësimit se përbën bazën juridike dhe titull ekzekutiv për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 dhe 22 par.1.2, i përmbarueshëm sipas nenit 24 par.3 dhe 5, i përshtatshëm për përmbarim sipas nenit 27 par.1 të LPP-së.

Kundër urdhërit mbi caktimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim, debitori i përmbarimit: Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës në Prishtinë.

Debitori i përmbarimit, me prapësimin e ushtruar, e ka kundërshtuar udhërin me të cilin është caktuar përmbarimi për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar edhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Përmbaruesi në urdhërin për përmbarim ka bërë konstatim të gabuar të drejtës materiale duke mos e cekur se në cilat prova është bazuar dhe ka kërkuar të bëhet pagesa për një pagë jubilarë në shumën prej 475.19€ pasi që në vendimin Nr.01-14-265/2020 të dt:17.04.2020, nuk është caktuar shuma e mjeteve monetare të cilat debitori duhet t'ia paguaj kreditorit. Dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi nuk mund të paraqitet si dokument ekzekutiv dhe se i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbarim, ashtu siç kërkohet me nenin 27 par.1 të LPP-së. Nga përmbajtja e propozimit shihet se propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim të nenit 144 të ligjit procedurën administrative, akti administrativ ekzekutohet kur hyn në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vet organi administrativ i cili e ka nxjerr këtë vendim, ndërsa vendimi Nr.01-14-265/2020 të dt:17.04.2020 nuk është bërë ende i ekzekutueshëm sepse sipas këshillës juridike pala e pakënaqur ka të drejtë në kontestimin e vendimit të cilën të drejtë debitori e ka shfrytëzuar dhe ka ushtruar padi për konflikt administrativ në gjykatën kompetente dhe lënda është në procedurë. Po ashtu theksojmë se akti administrativ ekzekutohet vetëm atëherë kur kanë përfunduar të gjitha procedurat administrative dhe paraprakisht i është dhënë mundësia personit fizik apo juridik që vullnetarisht të zbatoj aktin administrativ, ndërsa përmbaruesi privat ka kërkuar përmbarimin e vendimit, para se debitori ti shterë të gjitha procedurat administrative dhe pa kaluar afati parativ për përmbushjen e vendimit.

Andaj i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave të merr aktvendim dhe të pranohet prapësimi i debitorit si i bazuar, ndërsa propozimi për përmbarim- urdhëri përmbarimor P.nr.2613/20 të dt:16.10.2020 të anulohet si i kundërligjshëm pa bazë juridike.

Kreditori i përmbarimit me përgjigjen në prapësim përmes të autorizuarit të tij, i ka kundërshtuar pretendimet në prapësuese të debitorit të përmbarimit me arsyetimin se, vendimi i shkallës së dytë Nr.371/2020 i datës 20.07.2020 të inspektoratit të Punës është bërë i formës së prerë menjëherë, andaj si i tillë vendimi i inspektoratit të punës Nr.371/2020 i datës 20.07.2020 përmban të dy vultat atë të përmbarueshmërisë dhe të ekzekutueshmërisë. Sa i përket shumës Inspektorati i Punës me vendimin e saj ka obliguar debitorin që të bëjë pagesën e pagave jubilarë në bazë të pagës mujore të kreditorit dhe shuma është bazuar në listën e pagave, ndërsa si provë ne i kemi bashkangjitur dhe listën e pagës që ka cilësinë e dokumentit publik-zyrtar nga debitori, ashtu siç parashihet me LPP-në, e ku tregohet saktë paga e kreditorit, dhe si dëshmi i kemi bashkangjitur edhe ekspertizën financiare e cila do të vërteton shumën e saktë të pagave të cekura nga Inspektorati. Debitori në prapësimin e tij ka treguar që ka iniciuar edhe padi për konfliktin administrativ, mirëpo sipas nenit 22 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, pasia e parashtruar nuk e ndalon ekzekutueshmërinë e aktit administrativ andaj një pretendim i debitorit nuk qëndron. Nga shkaqet e theksuara më lartë i propozojmë gjykatës që të marrë aktvendim dhe prapësimin e debitorit të refuzohet si i pa bazuar dhe të vërtetohet urdhëri përmbarimor P.nr.2657/20 të dt:16.10.2020 si i bazuar, si dhe t'i kompensohen shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim sipas tarifës së OAK-së në shumën 156.00€.

Gjykata, pas shqyrtimit të propozimit për përmbarim dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjeti se propozimi për lejimin e përmbarimit duhet të refuzohet si i pabazuar për arsye se, dokumenti përmbarues mbi bazën e të cilit kreditori e ka ushtruar propozimin për lejimin e përmbarimit është i pa përshtatshëm për përmbarim, sepse nga ky dokument përmbarimor nuk dihet shuma të cilën debitori i përmbarimit duhet t'ia përmbushë ndaj kreditorit të përmbarimit por është theksuar se, obligohet debitori t'i bëjë kompensimin e një page mujore në emër të shpërblimit jubilar.

Me nenin 27, par.1 të LPP-së, është rregulluar se një dokument përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim, në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit dhe rrjedhimisht jo çdo vendim gjyqësor është titull ekzekutiv, në kuptimin që të jetë objekt i ekzekutimit të detyrueshëm, në rastin konkret Vendimi i Inspektoratit të Punës 01 Nr.14-265/2020 i datës 17.04.2020, nuk përmban objektin dhe shumën e përmbushjes së detyrimit, i njëjti përcakton vetëm detyrime por nuk jep shumë konkrete se cili është obligimi i kreditorit në raport me debitorin.

Bazuar në nenin 43 paragrafi 4 i LPP - së, është përcaktuar se: “Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.

Gjykata në kuptim të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.19/2023, datë 09.02.2023

Gjyqtari

Përparim Zeka

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.